



BASHKIA

TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Për: **Shoqëria “Kadra” sh.p.k**

Adresa: Rruga Nënë Tereza, Banesë Private me Nr.Pasurie 180/29, Zona Kadastrale
2372, Kamëz, Laknas, Tiranë

* * *

Procedura e prokurimit: ”Procedurë e Hapur”/ Marrëveshje Kuadër me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë për Konviktet e Shkollave të Mesme”, Loti i parë: ”Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme”

Numri i referencës së procedurës/lotit të dytë: **40793-01-17-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është ”Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme”, Tirane.

Fondi limit për lotin e parë : Blerje buke për Konviktet e Shkollave të Mesme 2.362.500 (dymilion e treqind e gjashtëdhjetë e dymijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit:Buxheti i Shtetit dhe buxheti i Bashkisë Tiranë.

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike Nr.3, date 22.01.2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1- Operatori ekonomik “ **Dajti Park 2007** ” sh.p.k
S

NUIS K11507003

Vlera e ofertës = **1.758.750 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH**

2- Operatori ekonomik “ **Dogel** ” sh.p.k

NUIS K59418208 E

Vlera e ofertës = **1.575,000** (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë) lekë pa TVSH.

3- Operatori ekonomik "MB Kurti" shpk

NUIS J64103483 H

Vlera e ofertës= **1.693.125** (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tremijë e njëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

4- Operatori ekonomik "Nelsa" sh.p.k
J71601012 S

NUIS

Vlera e ofertës = **2.047.500** (dymilion e dyzet e shtatëdhjetë e pesëqind) lekë pa TVSH.

5- Operatori ekonomik "Kadra" sh.p.k
K31321008J

NUIS

Vlera e ofertës = **1.693.125** (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tremijë e njëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

6- Operatori ekonomik "Erdis" shpk

NUIS K71804011J

Vlera e ofertës = **1.785.000** (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesëmijë) pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Operatori ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k

NUIS K11507003 S

2. Operatori ekonomik "Dogel" sh.p.k

NUIS K59418208 E

3. Operatori ekonomik "MB Kurti" shpk

NUIS J 64103483 H

4. Operatori ekonomik "Nelsa" sh.p.k
71601012 S

NUIS J

5. Operatori ekonomik "Erdis" shpk
J

NUIS K 71804011

6. Operatori ekonomik "Kadra" shpk
J

NUIS K 31322108

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik "Dajti Park 2007" shpk

NUIS K 11507003 S

Është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në kriteret e vecanta për kualifikim që operatori ekonomik të paraqesë foto të ambjentëve ku të jenë përcaktuar qartë linjat e prodhimit të bukës deri në prerje dhe ambalazhim final të produktit.

Në fotot e paraqitura nga ana e operatorit ekonomik "Dajti Park 2007" shpk nuk është paraqitur linjë prodhimi buke por janë paraqitur disa foto furre me dru duke mos plotësuar piken 1.3

“Kriteret e vecanta për kualifikim” të dokumentave të tenderit.

2. Operatori ekonomik “Dogel” sh.p.k

NUIS K 59418208 E

- a) Operatori ekonomik “Dogel” shpk nuk ka paraqitur leje mjedisore për linje prodhimi buke duke mos plotësuar piken 1.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik ku është kërkuar specifikisht nga Autoriteti kontraktor **“Linjë prodhimi buke e pajisur me leje mjedisore dhe leje higjieno sanitare”**.

- b) Operatori ekonomik “Dogel” shpk ka lidhur një kontratë huapërdorje për furrën e bukës me Z. Elez Rama më datë 25.02.2015 për të cilën nuk ka paraqitur dokumentin e pronësisë sic është kërkuar specifikisht në dokumentat e tenderit sa më poshtë:

*Operatori duhet të ketë në pronësi (vërtetuar me akti i pronësisë kopje e noterizuar) ose **me qera kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara dhe dokumentit të pronësisë në emër të qeradhënësit** ambiente të përshtatshme për prodhim dhe magazinim të artikullit bukë për periudhën e zbatimit të kontratës.*

Thënë kjo operatori ekonomik “Dogel” shpk nuk plotëson “Kriteret e vecanta për kualifikim, pika 1.3 Kapaciteti Teknik.

- c) Në funksion të realizimit të kontratës është kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim sa më poshtë cituar:

Operatori ekonomik duhet të **disponojë automjet** të përshtatshëm për transportin e bukës

Për automjetin të paraqiten **certifikatat e pronësisë**, kontratat e dhurimit apo të qirasë sipas rastit, si dhe dokumentacionin përkatës. Certifikatë e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe siguracionin e mjetit në dispozicion si dhe leje për transport mallrash (dokumentacioni i kërkuar të jetë i vlefshëm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi).

Për automjetin me targa TR 7257U të marrë me qera nga Z.Gazmend Çejku me kontratë qeraje Nr.1343 Rep, Nr. 444 Kol, datë 07.03.2014 nuk është paraqitur Certifikata e pronësisë së mjetit duke mos plotësuar kriteret e veçanta për kualifikim, pika 1.3 Kapaciteti Teknik.

3. Operatori ekonomik “MB Kurti” sh.p.k

NUIS J 64103483

H

Operatori ekonomik MB Kurti në dokumentacionin për furrë buke ka paraqitur furrën e bukës të marrë me qera në Libonik Korcë nëpërmjet kontratës së qerasë Nr. 610 Rep, Nr.572 Kol, datë 02.02.2017 të lidhur me Zj Fatime Zhuli. Nga shqyrtimi i dokumentacionit komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se për furrën e bukës nuk është paraqitur certifikata e pronësisë siç është kërkuar specifikisht në dokumentat e tenderit ku citohet:

*Operatori duhet të ketë në pronësi (vërtetuar me akti i pronësisë kopje e noterizuar) ose **me qera kundrejt kontratave përkatëse të noterizuara dhe dokumentit të pronësisë në***

emër të qeradhënësit ambjente të përshtatshme për prodhim dhe magazinim të artikullit buke për periudhën e zbatimit të kontratës.

Sa më sipër operatori ekonomik “MB Kurti” shpk nuk plotëson “Kriteret e Vecanta për Kualifikim”, pika 1.3 Kapaciteti teknik.

4. Operatori ekonomik “Nelsa ” sh.p.k
S

NUIS J 71601012

- a) Operatori ekonomik Nelsa shpk nuk ka paraqitur leje mjedisore për linjë prodhimi buke duke mos plotësuar piken 1.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik ku është kërkuar specifikisht nga Autoriteti Kontraktor **“Linjë prodhimi buke e pajisur me leje mjedisore dhe leje higjeno sanitare”**.
- b) Çertifikata ISO 9001-2008 në objektin e saj nuk ka të përcaktuar objektin e prokurimit për Lotin e parë prodhime brumi referuar kriterëve të vecanta për kualifikim pika 1.3, Kapaciteti Teknik.
- c) Çertifikata ISO 22000-2005 në objektin e saj nuk ka të përcaktuar objektin e prokurimit për Lotin e parë prodhime brumi referuar kriterëve të vecanta për kualifikim pika 1.3, Kapaciteti Teknik.
- d) Çertifikatat HACCP në objektin e saj nuk ka të përcaktuar objektin e prokurimit për Lotin e parë prodhime brumi referuar kriterëve të vecanta për kualifikim pika 1.3, Kapaciteti Teknik.

5. Operatori ekonomik “Erdis” shpk
J

NUIS K 71804011

- a) Çertifikata ISO 9001-2008 në objektin e saj nuk ka të përcaktuar objektin e prokurimit për Lotin e parë prodhime brumi referuar kriterëve të vecanta për kualifikim pika 1.3, Kapaciteti Teknik.
- b) Çertifikata ISO 22000-2005 në objektin e saj nuk ka të përcaktuar objektin e prokurimit për Lotin e parë prodhime brumi referuar kriterëve të vecanta për kualifikim pika 1.3, Kapaciteti Teknik.
- c) Çertifikatat HACCP në objektin e saj nuk ka të përcaktuar objektin e prokurimit për Lotin e parë prodhime brumi referuar kriterëve të vecanta për kualifikim pika 1.3, Kapaciteti Teknik.
- d) Operatori ekonomik Erdis shpk në dokumentacionin për furrë buke nuk ka paraqitur lejen mjedisore për linjë prodhimi buke duke mos plotësuar pikën 1.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim, kapaciteti teknik ku është kërkuar specifikisht nga Autoriteti kontraktor **“Linjë prodhimi buke e pajisur me leje mjedisore dhe leje higjeno sanitare”**.
- e) Operatori ekonomik “Erdis” shpk nuk plotëson kriterin për furnizime të ngjashme

referuar Kriteria të Veçanta për kualifikim, pika 1.3, Kapaciteti Teknik ku citohet:

Furnizime të së njëjtës natyrë në një vlerë **prej 945.000 (nëntëqind e dyzet e pesëmijë)** lekë pa tvsh, të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në plotësim të kësaj pike konstatohet se janë paraqitur kontrata si më poshtë:

1. Kontrata me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve Nr.2/5 Prot, date 09.01.2015 e cila në objektin e saj nuk ka të përfshirë objektin e prokurimit “Blerje buke” pra nuk konsiderohet kontratë e të njëjtës natyrë.
2. Kontratat e tjera të paraqitura janë kontratat e furnizimit me artikuj ushqimorë të institucioneve në varësi të Shërbimit Social Shtetëror për vitin 2017 ku Erdis shpk është në bashkëpunim me shoqërinë Nelsa në raporte në përqindje “Erdis” 25 % dhe Nelsa 75% ku referuar secilës kontratë konstatohet se:
 - Kontrata Nr.89/1 Prot , date 14.04.2017 lidhur me shtëpinë e Foshnjës Tiranë për zërin buke objekt prokurimi për Lotin e parë ka vlerën 256.700 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtëmijë e shtatëqind) për Erdis shpk në raport me përqindjen.
 - Kontrata Nr.58, date 19.04.2017 lidhur me Shtëpinë e të Moshuarve Tiranë është e përfshirë në të njëjtin preventiv me shtëpinë e foshnjës Tiranë duke iu referuar të njëjtës vlerë për zërin buke objekt prokurimi për Lotin e parë.
 - Kontratë Nr.148, date 04.05.2017 lidhur me Qendrën Polivalente ditore Kamëz për zërin buke objekt prokurimi për Lotin e parë ka vlerën 8500 (tetëmijë e pesëqind) lekë për Erdis shpk në raport me përqindjen.
 - Kontratë Nr.59, date 20.04.2017 për zërin buke objekt prokurimi për Lotin e parë ka vlerën 26.350 (njëzet e gjashtëmijë e treqind e pesëdhjetë) lekë për Erdis shpk në raport me përqindjen.
 - Kontratë Nr.83, date 20.04.2017 lidhur me Qendrën e Zhvillimit Rezidencial Durrës për zërin buke objekt prokurimi për Lotin e parë ka vlerën 42.500 (dyzet e dymijë e pesëqind) lekë për Erdis shpk në raport me përqindjen.
 - Kontratë Nr.59, date 26.04.2017 lidhur me Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit për zërin buke objekt prokurimi për Lotin e parë ka vlerën 13.600 (trembëdhjetëmijë e gjashtëqind) lekë për Erdis shpk në raport me përqindjen.
 - Kontratë Nr.151, date 24.04.2017 lidhur me Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë për zërin buke objekt prokurimi për Lotin e parë ka vlerën 46.123 (dyzet e gjashtëmijë e njëqind e njëzet e tre) lekë për Erdis shpk në raport me përqindjen.
 - Kontratë Nr.2014, date 24.04.2017 lidhur me QKTVDHF për zërin buke objekt prokurimi për Lotin e parë ka vlerën 51.000 (pesëdhjetë e njëmijë) lekë për Erdis shpk në raport me përqindjen.

Totali i vlerës së përlllogaritur për furnizime me natyre të njëjtë për lotin e parë për shoqërinë Erdis shpk është 444.773 (katërqind e dyzet e katërmijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa tvsh duke mos plotësuar vlerën prej 40% të fondit limit të lotit të parë respektivisht **945.000 (nëntëqind e dyzet e pesëmijë) lekë pa tvsh** në kundërshtim me pikën 1.3 Kapaciteti Teknik të Kriteve të Vecanta për Kualifikim.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

1. Operatori ekonomik “**Kadra**” sh.p.k

NUIS K 31321008 J

Vlera e ofertës = **1.693.125 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tremijë e njëqind e njëzet e pesë) pa TVSH**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme, Tirane me adresë Rruga: Jeronim De Rada prane Shkolles Teknike Ekonomik, tel: 355 42 23 3826 , brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23.02.2018

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të pikës 2 të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78, pika 5 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) pranë Autoritetit Kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme, më datë 27.02.2018 është paraqitur ankesë me shkrim nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” hyrë në Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme me Nr.108 Prot, datë 27.02.2018. Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave tender në mbështetje të pikës 3 të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit dhe shqyrtoi ankesën duke i kthyer përgjigje operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” shpk me anë të shkresës Nr.176, datë 01.03.2018 ku ka marrë pjesërisht në konsideratë ankimitin e shoqërisë “Dajti Park 2007” shpk.

Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” në mbështetje të pikës 6 të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) shpk ka ushtruar të drejtën e ankimitit pranë Komisionit të Prokurimit Publik me datë 03.03.2018 dhe ka vënë në dijeni autoritetin kontraktor Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme me anë të shkresës hyrese Nr.130, datë 08.03.2018.

Komisioni i Prokurimit publik me ane të shkresës Nr.421/1, datë 07.03.2018 ka urdheruar

autoritetin kontraktor të mbajë te pezulluar procedurën dhe të dërgojë informacion pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Me anë të shkresës Nr.191, datë 12.03.2018 Autoriteti Kontraktor i ka dërguar informacionin e kërkuar Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik me anë të Vendimit Nr.249/2018, datë 26.04.2018 hyre në Drejtorinë e Konvikteve të Shkollave të Mesme me Nr.226 Prot, datë 02.05.2018 vendos të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007”shpk dhe të lejoje Autoritetin Kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

Me respekt,

